



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201801432/12

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2019

**Lënda :** *Rekomandim për marjen e masave dhe regjistrimin të pronës prej 7600 m<sup>2</sup> e përfituar me AMTP-në nr. regj. 190, datë 15.11.1995, ndodhur në fshatin Vrinë, Konispol, në emër të D.M.*

**Drejtuar :** Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

**TIRANË**

**Për dijëni:** Ministrisë së Drejtësisë

**TIRANË**

Sikurse jeni në dijëni institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetasit D.M, i cili pretendon se ka aplikuar pranë institucionit tuaj për regjistrimin e një sipërfaqe toke prej 7600 m<sup>2</sup>, në parcelën 6221, me vendodhje në Vrinë-Bashkia Konispol, të cilën e ka përfituar me AMTP nr. 190, datë 15.11.1995, në emër të D.M. (Sqarojmë këtu se lidhur me ndryshimin e mbiemrit nga M. në M, ankuesi ka depozituar një vërtetim të datës 12.05.2017, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Sarandë, se ky ka ndryshuar mbiemrin me urdhërin nr.58, datë 06.12.2001 nga D.M në M). Gjithahtu ankuesi pretendon se ju i kërkoni riarzhonimin e të gjithë bllokut të parcelave ku ndodhet prona e tij, ndërkohë ai pretendon se vetë e ka bërë një gjë të tillë për pronën e tij.

Në përmbushje të misionit tonë kushtetues, për sqarimin dhe zgjidhjen e kësaj çështje, në referim të parashikimeve të Nenit 63, Pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: "Organet dhe funksionarët publik janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij", si dhe Nenit 19, Pika b, të Ligjit Nr. 8485, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar: "Avokati i popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin", ju jemi drejtuar me shkresë duke kërkuar shpjegime mbi këtë çështje. Me shkresën nr. 9549/1 prot., datë 01.10.2018 "Kthim përgjigje", na keni kthyer përgjigje duke pretenduar ndërmjet të tjerave se, pasuria nr. 1898, vol. 3, faqe 83 e përfituar me AMTP, nuk mund të regjistrohet pasi bie në zonë të mbrojtur të kategorisë A, kjo sipas VKM-së nr. 134, datë 20.02.2013.

Ndërkohë për këtë rast Drejtoria e Menaxhimit, Projekteve dhe Monitorimit, me shkresën nr. 1017/1 prot., datë 04.09.2018 “Kthim përgjigje”, ka konfirmuar se kjo pronë bie në zone të mbrojtuar të shkallës së parë, por nuk është kompetencë e kësaj drejtorie të vendosë nëse kjo pronë duhet të regjistrohet apo jo.

Gjithashtu, ju shpreheni se i jemi drejtuar edhe ZQRPP, si organ epror, për mendim nëse pajisja me çertifikatë pronësie e këtyre subjekteve, dëmton apo jo kategorinë e zonave A1 dhe A2, por deri në ato momente nuk kishte një përgjigje nga kjo zyrë. Për sqarimin e kësaj çështjeje i jemi drejtuar më tej me shkresë ZQRPP, duke kërkuar shpjegime mbi këtë çështje dhe zvarritjes pa fund të procesit. Me shkresën nr. 8146/1 prot., datë 23.10.2018, ZQRPP na dërgon për dijeni se ju ka kërkuar informacion në mënyrë të detajuar lidhur me shkaqet ligjore të mosrealizimit të kërkesës së subjektit. Me shkresën nr. 11520 prot., datë 16.11.2018 “Kthim përgjigje”, keni kthyer përsëri të njëjtën përgjigje, ku ndër të tjera jeni shprehur se në zbatim të VKM nr. 134, datë 20.02.2013 (e cila përcakton kufijtë e nënzona të Parkut Kombëtar të Butrintit), këto nënzona janë përcaktuar me vlera të mëdha natyrore, si dhe zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes dhe veprimtaritë ekonomike kryhen në përputhje me objektivat e Parkut Kombëtar të Butrintit dhe dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu, ju përsëri shpreheni se Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ju ka kthyer përgjigje se këto zona kanë status mbrojtjeje të shkallës së parë, por pa sqaruar se cili është ndalimi ligjor apo dispozita ligjore që kufizon të drejtën e pronësisë së ankuesit dhe përbën pengesë për regjistrimin e saj. Ndërkohë, me shkresën nr. 7531/1 prot., datë 22.10.2018, ZQRPP Tiranë, ndër të tjera shprehet se me shkresën nr. 7531/1 prot., datë 22.10.2018, ju është drejtuar duke dhënë rekomandimet ligjore për të vijuar me trajtimin e problematikës së krijuar dhe njoftimin e palëve të interesuara. ZQRPP ju ka rekomanduar të verifikoni nëse në zbatim të pikes 4 të VKM nr. 134, datë 20.02.2013, mund të vijojë trajtimi i kërkesës së ankuesit për regjistrimin e pronës dhe pajisjen e tij me dokument pronësie. Duke qenë se ankuesit nuk ju ofrua shërbimi i kërkuar edhe pas ndërhyrjes nga institucioni ynë dhe ZQRPP dhe ju nuk na dërguat një përgjigje mbi zgjidhjen e kësaj çështjeje, ju drejtuam përsëri me shkresën nr. K3/DH30-13 prot., datë 18.01.2019, duke rikërkuar shpjegime mbi këtë rast dhe arsyes konkrete ligjore që përbën pengesë për zgjidhjen e saj konform akteve ligjore e nënligjore. Me shkresën nr. 590/1 prot., datë 23.01.2019 “Kthim përgjigje”, keni kthyer të njëjtën përgjigje si më parë pa na sqaruar mbi dispozitën ligjore e cila përcakton ndalimin ligjor për regjistrimin e pronës në këto zona.

**Së pari:** Legjislacioni i brendshëm në fuqi, që trajton regjimin juridik të së drejtës së pronës dhe kufizimin e kësaj të drejte parashikon garanci kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të saj, po ashtu edhe konventat në të cilat ka aderuar Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

Në nenin 41, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton shprehimisht se:

- “1. E drejta e pronës private është e garantuar.*
- 2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.*
- 3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.*
- 4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.*

5. *Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.*”

Ndërkohë në pikën 1, të nenit 42, të Kushtetutës, përcaktohet: *“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor”*.

Kufizimi i së drejtës së pronësisë mund të ndodhë vetëm në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 17, të Kushtetutës ku përcaktohet se: *“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”*.

E drejta e pronës është e parashikuar dhe sanksionuar edhe në nenin 1, të Protokollit 1, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. E drejta e shtetasve për shpronësim, parashikohet në këtë konventë, konkretisht Neni 1, i Protokollit 1 të saj ndër të tjera parashikon: *“Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”*.

Neni 153 i Kodit Civil parashikon: *“Askush nuk mund të shpronësohet ose t’i kufizohet e drejta e ushtrimit të së drejtës të pronës që barazohet me shpronësimin, përveçse kur këtë e kërkojnë interesa publike dhe kurdoherë kundrejt një shpërblimi të drejtë”*, ndërsa Neni 192 i Kodit Civil *“Sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji”*.

*Ligji nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, parashikon rregulla të qarta për regjistrimin e pasurive të paluajtshme në regjistrat e zyrave të regjistrimit dhe në asnjë rast nuk parashikon dhe nuk mund të parashikojë kufizime mbi të drejtën e pronësisë apo ndalim ligjor për regjistrimin e të drejtave tashmë të fituara nga organet kompetente të parashikuara me ligj. Ndërsa *ligji 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”*, neni 52/2 i tij parashikon *“Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë janë pasuri të paluajtshme, prone publike ose private”*. VKM nr. 693, datë 10.11.2005 *“Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “Park Kombëtar”*, ndryshuar me VKM nr. 134, datë 20.02.2013. VKM nr. 134, datë 20.02.2013 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.693, datë 10.11.2005 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e kompleksit Ligatinor të Butrintit “Park Kombëtar”*, parashikon vetëm ndarjen e nënzoneve të Parkun Kombëtar të Butrintit.

**Së dyti:** Qëndrimin tuaj në lidhje me këtë çështje e konsiderojmë të padrejtë, të pabazuar në ligj, në shkellje të së drejtës së pronësisë dhe të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. E drejta e pronësisë si një drejtë themelore gjen mbështetje dhe mbrojtje në sanksionimin e nenit 41 të kushtetutës, neni 1 i Protokollit shtesë nr. 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kodi Civil dhe në akte ligjore e nënligjore të miratuara për këtë qëllim.

Në këtë çështje vihet në diskutim respektimi i së drejtës së pronësisë së ligjshme të ankuesit, si një e drejtë themelore kushtetuese dhe procesi i rregullt ligjor i nevojshëm për kufizimin e të drejtave, që lidhen me këtë pronësi.

Refuzimi juaj për regjistrimin e pronës nuk gjen mbështetje ligjore dhe cënon të drejtën e pronësisë së ankuesit, pasi atij i është mohuar një prej tagrave të saj e konkretisht të drejta e disponimit.

Në vijim ju kujtojmë se ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, parashikon që këto zona janë pasuri publike ose private dhe nuk ka ndalim ligjor për regjistrimin e tyre apo kufizime të të drejtës së pronësisë së fituara me ligj.

Ankuesi e ka fitur pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme/tokën në bazë të parashikimeve ligjore, pra me ligjin nr. 7501/1991, që përbën një nga mënyrat e fitimit të së drejtës së pronësisë dhe tashmë është titullar i saj edhe pse nuk e ka të regjistruar atë.

Regjimi i i pasurive të paluajtshme realizohet nëpërmjet mbajtjes së regjistrimit publik dhe ka si objekt regjistrimin e akteve që krijojnë, ndryshojnë ose përfundojnë të drejta pronësie si dhe të drejta reale mbi pasuritë e paluajtshme dhe pasuritë e luajtshme të regjistruara. Aktet që duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme janë të përcaktuara qartë në parashikimet e nenit 193 të Kodit Civil dhe regjistrimi i pronës në regjistrat publike të zyrave të regjistrimit ka vlerë deklarative, njohëse dhe nuk ka vlerë krijuese. Regjistrimi i pronës në ZVRPP nuk të bën titullar të së drejtës, pasi janë organe të tjera shtetërore të cilat janë ngarkuara me këto tagra. Detyrimi i këtyre zyrave është regjistrimi i pasurive të paluajtshme që kanë një titull pronësie dhe janë të shoqëruara me dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës. Nuk mund të vihen në dyshim të drejtat tashmë të fituara nga institucionet kompetente dhe të ngarkuara me ligj për këtë qëllim, nga një institucion që në kompetencë të tij ka regjistrimin e të drejtave të fituara. Gjykata kushtetuese në praktikën e saj të konsoliduar kushtetuese është shprehur se, çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt” përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi, ku kërkohet të cenohen të drejtat e fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre.

Sjellim në vëmendjen tuaj se ankuesi disponon aktin me të cilin ka fituar të drejtën e pronësisë dhe ky akt është i vlefshëm dhe asnjëherë nuk është vënë në diskutim vlefshmëria e tij. Konkretisht AMTP nr. 190 akti, datë 15.11.1995, është lëshuar nga Komisioni i Tokës në Fshat, organ kompetent i parashikuar me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 dhe i plotëson kriteret formale dhe ato të përmbajtjes për vlefshmërinë e tij. Tashmë e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës prej 7600 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Vrinë, Bashkia Konispol, është një e drejtë e fituar nga ankuesi dhe vetëm institucionet e parashikuara me ligj mund të vendosin mbi vlefshmërinë e tij, ndërsa institucionet e tjera kanë detyrimin ligjor për zbatimin dhe respektimin e kësaj të drejte dhe nuk mund të vendosin kufizime mbi të. Çdo kufizim i vendosur mbi të drejtën e pronësisë, jashtë parashikimeve ligjore, përbën cënim të së drejtës së pronësisë dhe është antikushtetues. Neni 17 I Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon: “1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në proporcion me gjendjen që e ka diktuar atë”.

Pra, asnjë institucion shtetëror nuk mund të vendosë kufizime mbi të drejtën e pronësisë, kufizime të tilla mund të vendosen vetëm me ligj dhe nga institucionet shtetërore që ligji

jua ka njohur këtë tagër. Institucioni juaj me qëndrimin e tij, ka cënuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, ndaj ankuesit, si një e drejtë ligjore e kushtetuese.

Nga tërësia e akteve të depozituara nga ankuesi dhe korespondenca e mbajtur me ju, konstatohet se me shkresën tuaj nr. 590/1 prot., datë 23.01.2019 “Kthim përgjigje”, ndër të tjera shpreheni, nga verifikimi i dokumentacionit hartografik këto pasuri bien në zonat A1 dhe A2 të Parkut Kombëtar të Butrintit, të miratuar me VKM nr. 134, datë 20.02.2013, e cila përcakton kufijtë e nënzonave të tij dhe që mbrohet nga UNESCO. Këto nënzona janë përcaktuar me vlera të mëdha natyrore, si dhe zbatohet shkalla e pare e mbrojtjes dhe veprimtaritë ekonomike kryhen në përputhje me objektivat e parkut dhe dispozitave ligjore në fuqi. Ndërkohë, në asnjë rast nuk citoni dispozitën ligjore që parashikon kufizimin e së drejtës së pronësisë, në këtë rast. Gjithashtu ju shpreheni se për këtë qëllim i jeni drejtuar Agjensisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, për mendim, por ky institucion thjesht ka konfirmuar faktin se kjo prone bie në zonat e mbrojtura, por pa ju orientuar mbi regjistrimin e pronës dhe me të drejtë sepse nuk është kompetencë e këtij institucioni vlerësimi i regjistrimit apo jo të pronave/tokave.

Në referim edhe të dispozitave të ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, nuk rezulton të ketë ndalim ligjor për regjistrimin e tyre, përkundrazi, ky ligj në kreun VII të tij “Pronësia dhe të drejtat në zonat e mbrojtura”, neni 52/2, parashikon: “Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë janë pasuri të paluajtshme, prone publike dhe private”, duke rikonfirmuar pronësinë private mbi këto zona. Ndërsa neni 53 parashikon pronësinë private, duke rikonfirmuar përsëri atë brenda zonave të mbrojtura, konkretisht: “1. Për interes të mbrojtjes së natyrës e të biodiversitetit, në përbërje të zonave të mbrojtura përfshihen edhe toka, pyje, kullota e të tjera prona të paluajtshme private, duke marrë, në çdo rast, pëlqimin e tyre paraprak.

2. Territoret dhe objektet private, të përfshira në zonat e mbrojtura mjedisore, mbeten në pronësi private. Ato administrohen e përdoren prej pronarit/ve/bashkëpronarëve ose prej përdoruesit të ligjshëm, vetëm sipas kërkesave të planit të menaxhimit të zonës dhe zonimit të miratuar.

3. Pronarët dhe përdoruesit e territorit, që do të shpallet zonë e mbrojtur mjedisore, si dhe çdo person ose autoritet, që ka interesa në zonë, kanë të drejtë të ngrenë kundërshtime ndaj synimit për ta shpallur zonë të mbrojtur. Kundërshtimet paraqiten me shkrim brenda 30 ditëve nga data e publikimit të synimit për të shpallur zonën e mbrojtur ose për të zgjeruar sipërfaqen e zonës ekzistuese në ministri.

4. Ministri ia njofton kundërshtimet KKT-së dhe kundër vendimit të kësaj të fundit, të interesuarit kanë të drejtë të ankohen në gjykatën administrative, referuar legjislacionit në fuqi.

5. Nga data e njoftimit të propozimit për shpalljen e një territori “zonë e mbrojtur mjedisore” e deri në hyrjen në fuqi të vendimit që e shpall atë zonë të mbrojtur, pronarëve dhe përdoruesve të tokës, pyjeve, kullotave u ndalohen ndërhyrjet që ndryshojnë ose dëmtojnë gjendjen dhe vlerat natyrore të territorit, të propozuar për mbrojtje”.

Sikurse e vërejmë, ky ligj në çdo dispozitë të tij jo vetëm që nuk parashikon kufizime të së drejtës së pronësisë, por rikonfirmon të drejtën e pronës private në zonat e mbrojtura, madje shkon edhe më tej në parashikimet e tij ligjore, konkretisht në nenin 54, duke u

shprehur se nëse pronari i pronës nuk është dakord me administrimin dhe menaxhimin e saj sipas planit të menaxhimit, ai ka të drejtë të kërkojë kompensimin me një sipërfaqe tjetër toke ose shpronësim për interes publik: Neni 54 i ligjit nr. 81/2017, përcakton:

*“1. Pronarëve privatë, prona e të cilëve përfshihet brenda territorit të zonës së mbrojtur mjedisore, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, u njihet e drejta e administrimit dhe përdorimit të saj, sipas kërkesave të planit të menaxhimit. Në rast se pronari nuk është dakord, ai gëzon të drejtën të kërkojë kompensimin me një sipërfaqe tjetër jashtë zonës ose shpronësim për interes publik, sipas legjislacionit në fuqi”.*

Gjatë gjithë korespondencës zyrtare me institucionin tuaj kemi këmbëngulur duke ju kërkuar dispozitën ligjore që përbën pengesë për regjistrimin e pronës, por i vetmi pretendim juaj ka qenë fakti që bie në zonë të mbrojtur të kategorisë A1 dhe A2, parashikuar në pikën 4 të VKM-së nr. 134, datë 20.02.2013, pa na sqaruar mbi atë çfarë kemi kërkuar. Sikurse edhe e sqaruam më lart, kufizime të së drejtës së pronësisë mund të vendosen vetëm me ligj (dhe jo me akt nënligjor) dhe për interes publik dhe në këtë rast ligji për zonat e mbrojtura nuk parashikon ndalim ligjor, madje e rikonfirmon pronësinë private mbi zonat e mbrojtura. Por edhe në hipotezën nëse këto kufizime mund të vendoseshin me akt nënligjor, përsëri nuk konstatohet në asnjë pikë të VKM-së nr. 134, datë 20.02.2013, të cilës ju i referoheni, ku të jetë përcaktuar ndalim ligjor për regjistrimin e pronave që përfshihen në zonat e mbrojtura. Pika 4 e VKM nr. 134, datë 20.02.2013, të cilës ju i referoheni në shkresën tuaj, parashikon: *“Parku Kombëtar I Butrintit ndahet në nënzona administrimi, si më poshtë vijon:*

- a) *Nënzona qendrore, shënuar në hartë me shkronjën “A” (A1,A2,A3), me sipërfaqe 3838.75 ha, që përcaktohen si nënzona me vlera të mëdha për natyrën dhe biodiversitetin dhe siguron një territor natyror të pashqetësuar, në të cilin përfshihen habitatet natyrore dhe zonat fito-klimatike, pyjet e vjetra dhe ato natyrore mesdhetare. Në këtë nënzona zbatohet shkalla e pare e mbrojtjes. Veprimtaritë ekonomike e sociale kryhen në përputhje me objektivat, sipas përcaktimeve të bëra në planin e menaxhimit të Parkut Kombëtar të Butrintit dhe dispozitave ligjore në fuqi”.*

Sa më sipër, arrijmë në përfundimin se institucioni juaj me veprimet e mosveprimet e tij ka kryer veprimtari të kundërligjshme, duke zvarritur procesin e regjistrimit të pronës së ankuesit, gjë që ka cuar në cënimin e së drejtës së pronësisë së tij dhe të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Gjatë trajtimit të kësaj çështje shohim me vend të sjellim në vëmendjen tuaj parimin e përgjegjësisë në veprimtarinë e organeve publike, të parashikuar në nenin 15, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se: *“Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktajnë palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.* Kjo pasi mosregjistrimi i pronës në emër të ankuesit mund të sjellë pasoja juridike dhe dëme pasurore për ankuesin dhe familjen e tij.

Në këtë këndvështrim, duam t'ju kujtojmë edhe një përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Europian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës

publike, sipas të cilit: *“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”*.

Ndërkohë sjellim në vëmendje detyrimin e pikës 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet:

*“Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”*.

Mosveprimi juaj dhe zvarritja e këtij procesi passjell shkelje të të drejtave të ligjshme të pronësisë së ankuesit dhe dëmtim të interesave të tij pasurore.

Në këto kushte, nëse nuk do ta bëni normalisht regjistrimin e pronës së pretenduar të ankuesit, në rrugë administrative, në bazë të akteve ligjore e normative në fuqi ai ka të drejtë ti drejtohet gjykatës për realizimin e të drejtës së tij. Kjo do të shtojë detyrimet financiare të institucionit tuaj, si shpenzime gjyqësore, përmbarimore, burimet njerëzore etj., duke rënduar kështu padrejtësisht buxhetin tuaj/buxhetin e shtetit. Por nga ana tjetër, Institucioni i Avokatit të Popullit apo ankuesi, kanë të drejtë ti drejtojen institucioneve kompetente për vënien para përgjegjësisë ligjore të personit përgjegjës, për shpërdorim detyre. Ndërkohë, ju kujtojmë edhe të drejtën ligjore të ankuesit për të kërkuar në rrugë administrative e gjyqësore, shpërblimin e demit të shkaktuar si pasojë e shkeljes së kësaj të drejte.

**Si konkluzion**, në zbatim të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet: *3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”, si dhe nenit 21 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, i cili parashikon se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime: b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*:

## REKOMANDOJMË

1. Marrjen e masave të menjëhershme për regjistrimin të pronës prej 7600 m<sup>2</sup> e përfituar me AMTP-në nr. regj. 190, datë 15.11.1995, ndodhur në fshatin Vrinë, Konispol, në emër të D.M/M.
2. Nxjerrjen e përgjegjësisë administrative, për shkeljen e të drejtave të ankuesit, në rastin konkret shkeljen e së drejtës së pronësisë shtetasit D.M, si dhe marrjen e masave përkatëse për të mos u përsëritur më kjo procedurë që përbën premisë për shkelje të të drejtave të njeriut.

Në zbatim të nenit 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, lutemi të na vini në dijeni mbi qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi dhe masat e marra për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

**KOMISIONERI**

**Prof.As.Dr. Erjona BANA (Canaj)**

*Konc. Suzana Cena*  
*Date: 07.05.2019*